



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 467 Prot.

Durrës më, 18 / 03 / 2022

VENDIM

Nr 14 , datë 18.03 2022

PËR

**"MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFËS SË STUDIMIT, PËR PROGRAMIN E
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË SHKENCA EKONOMIKE,
PRANË FAKULTETIT TË BIZNESIT NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 3/ç ku citohet se: "Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj", Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vendimit të Senati Akademik nr.32, datë 16.04.2021, vendimit të Bordit të Administrimit nr.21, datë 27.04.2021, Urdhërit të MAS nr. 134, datë 17.03.2022, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e studimit, për studentët të cilët regjistrohen për herë të parë, në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkenca Ekonomike", pranë Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Tarifa e aplikimit për kandidatët të cilët do të aplikojnë për herë të parë në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë, do të jetë 3000 (tre mijë) lekë.
3. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues të cilët do të regjistrohen për herë të parë në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë do të jetë 5000 (pesë mijë) lekë.
4. Tarifa vjetore e shkollimit për programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Shkenca Ekonomike do të jetë 120.000 lekë.
5. Ky vendim kalon për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Dekani i Fakultetit të Biznesit
 - Administratori

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Ksencela SOTIROFSKI

